



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 06.06.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **05.06.2024** të parashtruar nga Operatori Ekonomik " KOSPROD " SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi, instalimi dhe servisimi me kamera, projektor, TV, fotoaparate, Sistem zërimi, ndriçim profesional ", Nr. i prokurimit- 632-24-1635-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-24-014-121, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " KOSPROD " SH.P.K., e dt.05.06.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi, instalimi dhe servisimi me kamera, projektor, TV, fotoaparate, Sistem zërimi, ndriçim profesional ", Nr. i prokurimit- 632-24-1635-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-24-014-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 03.06.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **03.06.2024**;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik " KOSPROD " SH.P.K. me dt.05.06.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, instalimi dhe servisimi me

kamera, projektor, TV, fotoaparati, Sistem zërimi, ndriçim profesional “, Nr. i prokurimit-632-24-1635-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-24-014-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 06.06.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja nuk qëndrojnë, sepse pasi që Autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë, ju për inxhinierin e elektroteknikës – drejtimi elektroteknikë nuk e keni prezentuar certifikatën në fushën e programimit me çka nuk keni plotësuar kërkesën e Autoritetit kontraktues në FDT-ë.

Ju keni kërkuar që të ndërroni inxhinierin, e cila gjë është në kundërshtim me ligjin, sepse sipas nenit 72 të LPP-së, mund të kërkojen ose prezantohen vetëm dokumente ekzistenca e të cilave është e fiksuar:

Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankese pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

